



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 37, datë 30.03.2026

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES PËR OBJEKTIN:
“WIND TOWER”, KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE SHËRBIME, ME 22 KATE MBI
TOKË DHE 4 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” i ndryshuar, nenit 13/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Bregu” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues për objektin: “Wind Tower”, Kompleks rezidencial dhe shërbime, me 22 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 19.02.2025 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, nga subjekti zhvillues shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k në subjekt zhvillues shoqërinë “Bregu” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
E NEA KARAKAÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 10 /04/ 2026